



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1364 Prot.

Tiranë, më 02.07.2026

**VENDIM QARKULLUES**

Nr. 49 Datë 02.07 2026

**“PËR  
MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT  
BACHELOR NË "DIETOLOGJI" NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TË  
REHABILITIMIT" DHE UNIVERSITETIT "MAGNA GRECIA" TË  
KATANXAROS NË ITALI”**

Mbështetur në nenin 3, 49 dhe 80 të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në LAL në Republikën e Shqipërisë", Vendimin nr. 57 datë 29.01.2020 "Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës", Udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, vendimin nr.310 datë 11.05.2022 "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 7, 43, 73 të Statutit të UST-së, në nenin 24 të Rregullores së UST-së, në Vendimin Qarkullues të Rektoratit nr.90 datë 01.07.2026 "Për miratim të Rregullores së programit të përbashkët të studimit Bachelor në "Dietologji", shkresën e Ministrisë së Arsimit nr.5049 Prot., datë 30.06.2026 "Njoftim mbi vlerësimin e aplikimeve", shkresën nr. 2729/7 prot., datë 01.07.2026 të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit "Përcjellje për miratim të Rregullores së programit të përbashkët të studimit Bachelor në "Dietologji", në Vendimin Qarkullues të Senatit Akademik nr. 99 dt 01.07.2026, Bordi i Administrimit me Vendim Qarkullues datë 02.07.2026,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e hapjes së programit të përbashkët të studimit Bachelor në "Dietologji".
2. Programi i përbashkët i studimit do të zhvillohet në gjuhën angleze.
3. Kodi i programit të përbashkët të studimit është P63BA09151 (shkresa bashkëlidhur)

4. Efektet financiare që burojnë nga kjo marëveshje do të miratohen në buxhetin e cdo viti.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al).

**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**Artur COBANI**

